



**REPUBLIKA E SHQIPERISË**  
**MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT**  
**AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT**  
**DREJTORIA E VLERËSIMIT TË IMPAKTIT DHE LIÇENSIMIT**

AN140120230003

Tiranë, më 19.01.2023

Komisioni 09

## DEKLARATË MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM 714, datë: 06.11.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM 686, datë: 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave, përgjegjesive e afateve, për zhvillimin e procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, të ndryshuar, dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

### VENDOSI:

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

**Personi juridik:** “BRATAJ STONE 22” Sh.p.k.

**Nr. NIPT-i:** M26814207E

**Adresa e selisë:** Lagjja Pavaresia, Rruga "Cajupi", Pallati Ringjallja, Kati 2, Nr. 4, Vlore

**Personi përgjegjës:** Daniel Lakuriqi

Për të zhvilluar projektin “**Shfrytëzim i gurit gëlqeror**”

Aplikimi është bërë referuar ligjit Nr. 10 440, date: 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I, “Projektet që i nënshtrohen Proçedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”, Pika 19. Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.

**Vendndodhja:** Zona minerare, nr.270/5, Brataj, Qarku Vlore

**Të dhëna teknike:**

Sipërfaqe (Sipas Njoftimit fitues): 0.240 km<sup>2</sup>

Lloji i mineralit: Gur gëlqeror

*(Bashkangjitur vendimit, gjeni aneksin me hartën topografike dhe koordinatat metrike, ku tregohet vendodhja e objektit)*

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

**Miratimi i lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;**

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

### **1. Qëndrimin e Ministrisë dhe sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi:**

*Drejtoritë Teknike të Ministrisë shprehen:* Me qëllim mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis dhe në zbatim të legjislacionit përkatës për këtë fushë, sugjerohet që gjatë fazës së ushtrimit të aktivitetit, duhet të mbahen në konsideratë rekomandimet e mëposhtme:

- Të respektohen normat e lejuara të shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe lëndës së ngurtë pezull, në zbatim të VKM-së nr. 435, datë 12.9.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”;

- Të spërkatën rregullisht me ujë rrugët e transportit, për mbajtjen nën kontroll të pluhurformimit, si dhe forcimin e zbatimit të këtyre masave edhe më shumë në kohën e thatë dhe me erë, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”;

- Automjetet transportuese, të mos ngarkohen më shumë së kapaciteti i tyre mbajtës, si dhe të mbulohen me struktura të posaçme, për të shmangur përhapjen e pluhurave dhe derdhjen e materialeve që transportohen, në zbatim të VKM-së nr. 412, datë 19.6.2019 “Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit”.

- Gjithashtu me qëllim mbrojtjen e mjedisit, nëse do të ketë përdorim të lëndëve plasëse, përdorimi i tyre të bëhet në përputhje me Ligjin nr. 74/2021 “Për hedhjen në treg dhe mbikëqyrjen e lëndëve plasëse për përdorim civil”.

- Në zbatim të legjislacionit përkatës për fushën e ndryshimeve klimatike, sugjerohet që të kryhet rehabilitimi i plotë i sipërfaqeve të gjelbra të dëmtuara si rezultat i ushtrimit të aktivitetit.

- Sugjerohet që mbetjet e gjeneruara gjatë zhvillimit të aktivitetit të menaxhohen sipas kuadrit ligjor në fuqi në fushën e mbetjeve.

Sugjerohet të merret mendimi i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.

• Sa i takon sektorit të pyjeve, vlerëson se:

- nuk jep formën e përdorimit të sipërfaqes pyjore/kullosore dhe treguesit kadastralë;

- nga institucioni që ka dhënë lejen duhet të jepet informacion nëse është patur parasysh dhe zbatuar neni 10, pika 6, e ligjit 57/2020, datë 30.4.2020 “Për Pyjet”;

- në çdo rast duhet të kihet parasysh zbatimi me rigorizitet i nenit 12, të ligjit 57/2020, datë 30.4.2020 “Për Pyjet”.

• Sa i takon sektorit të biodiversitetit, sugjeron që subjekti gjatë zhvillimit të aktivitetit duhet ti përmbahet legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e natyrës dhe konkretisht ligjeve: Ligjin nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit” i ndryshuar; Ligjin nr.10 006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër” i ndryshuar, si dhe të bëjë rehabilitim e zonës me mbjellje pemësh;

• Sa i takon sektorit të cilësisë dhe pastërtisë së mjedisit shprehet që subjekti gjatë zhvillimit të aktivitetit duhet ti përmbahet legjislacionit në fuqi në lidhje me zhurmat.

Bazuar në nenin 12, pika 1 e ligjit nr . 10440 / 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar, në rast se zgjidhni pikën “a” apo “b” të referencës ligjore së sipërcituar, në Deklaratën Mjedisore të vendosen kushte të detajuara përsa i përket mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimit të pyjeve, emetimeve në ajër, shkarkimeve të ujrave të ndotura, menaxhimit të mbetjeve, etj. të cilat

duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis.

*Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura* shprehet: Bazuar në planvendosjen dhe koordinatat e aplikimit, sipërfaqja ku kërkohet të zhvillohet aktiviteti i “Shfrytëzimit të mineralit të gëlqerorëve të mermerizuar, Zona nr. 270/5, objekti “Brataj”, Vlorë, me zhvillues dhe aplikues “BRATAJ STONE 22” me AN140120230003, ndodhet brenda zonës buferike të monumentit natyror, rreth 160 metra larg MN “Rrethi i Plakës Brataj”, shpallur me VKM nr. 187, datë 25.3.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa” të VKM nr. 303, datë 10.5.2019, “Për miratimin e listës së rishikuar, të përditësuar, të monumenteve të natyrës shqiptare”.

Referuar ligjit nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, neni 17, pika 2 dhe 3 citon se; Në një “Monument natyror” zbatohet shkalla e mbrojtjes, e njëjtë me “Rezervën strikte”. Zona mbrohet e menaxhohet për ruajtjen e karakteristikave dhe dukurive të veçanta natyrore, kulturore, historike e arkeologjike, për të cilat është shpallur monument. Monumentet natyrore rrethohen nga zona buferike me gjerësi deri në 200 metra nga perimetri i monumentit”.

Në kushtet kur projekti i shfrytëzimit do të realizohet larg kësaj zone, sipas planimetrisë së dërguar nga aplikuesi (referencë harta bashkëngjitur), duke mbajtur në konsideratë distancën 200 m nga monumenti natyror “Rrethi i plakës”, zhvilluesi të respektojë regjimin e ruajtjes dhe kufirin e monumentit të natyrës gjatë zbatimit të projektit.

*Agjencia Rajonale e Mjedisit shprehet me sugjerime:*

- Të bëhet menaxhimi i mirë i mbetjeve sterile dhe dherave që prodhohen gjatë fazës së zbulimit të mineralit gur gëlqeror duke u sistemuar në sheshin e depozitimit të përcaktuar brenda sipërfaqes që kërkohet leja minerare.
- Mbetjet inerte që do të gjenerohen të trajtohen sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”
- Të evitohet efekti i erozionit.
- Të bëhet sistemimimi i dherave në tarracat e shesheve të shkallëve për të gjithë sipërfaqen që do të shfrytëzohet për të krijuar sipërfaqet për mbjellje, shkurrësh ose barishtesh të zonës duke përmirësuar dhe peisazhin estetik.
- Mbetjet sterile dhe inerte të ripërdoren për rehabilitimin e zonës së shfrytëzimit dhe për ndërtimin e një sërë rrugësh të brendshme në zonën e karrierës.
- Të përdoret ujë për lagjen e territorit në formë spërkatje për shmangien e pluhurave dhe këto ujëra së bashku me ujërat e shiut të grumbullohen në vaska dekantimi para se të derdhen në kanalet e zonës.
- Të monitorohet niveli i zhurmave sipas Udhëzimit Nr.8, datë 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”.
- Të zbatohet legjislacioni mjedisor në fuqi gjatë shfrytëzimit.
- Territori ku kryhet aktiviteti minerar duhet të rrethohet me tabela paralajmëruese ku të tregohet për punimet që kryhen, rradhën e kryerjes së tyre.
- Të kryhet rehabilitimi përfundimtar i shkallëve të karrierës, shesheve të karrierës, rrugëve jashtë karriere, shesheve të depozitimit të sterileve etj.

## **2. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:**

*Konsultimi me publikun:* U krye në datën 09.01.2023. Morën pjesë përfaqësues nga komuniteti i zonës, përfaqësues nga Pushteti Vendor si dhe nga Drejtoria Rajonale e Mjedisit dhe përfaqësues nga studio mjedisore. Në takim është prezantuar projekti, janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve, të cilat do të merren parasysh nga ana e investitorëve, gjatë kohës së shfrytëzimit. Nga ana e investitoreve iu sigurova të pranishmeve që do të merren të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, duke mos cënuar jetën e banorëve. Kërkesat e pjesëmarrësve, do të mbahen parasysh, në fazën kur shoqëria do të fillojë procedurat për fazën e shfrytëzimit.

### **3. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi;**

Zhvillimi i aktivitetit është në përputhje me:

- Në mendimin e anëtarëve të Komisionit 09, datë 19.01.2023, i mbledhur në zbatim të Urdhërit nr.106, datë 19.05.2022, "Një ndryshim në Urdhërin nr.75, datë 13.04.2022, për "Krijimin e komisionit teknik për shqyrtimin e kërkesave që i nënshtrohen procedurës paraprake dhe të thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis";
- Në Njoftimin Fitues me Nr. 7684/2 Prot. datë 08.011.2022, nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, për Zonën Minerare, nr.270/5, Brataj, Qarku Vlorë.
- Mendimin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura;
- Mendimin e Agjencisë Rajonale të Mjedisit.

### **4. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme:**

#### **4.1 Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT / Bashkia / Njësi Administrative) dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.**

4.2 Ky vendim nuk është leje zhvillimi përfundimtare për zbatimin e këtij projekti, por është një dokument i cili lëshohet me kusht që në rast se do të zhvillohet ky aktivitet, duhet të zbatohet kushtet e vendosura si detyrim që vjen nga Ligji Nr. 10431, datë 9.6.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", si dhe Ligji nr. 10 440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", të ndryshuar, KREU I, Neni 1, Pika a); KREU II, Neni 7, Pika 1; KREU V, Neni 20, Pika 1.

4.3 Në rast se gjatë punimeve shfaqen elemente të tillë si: objekte kulturi, gjurmë arkeologjike, burime ujore etj, subjekti të ndërpresë punimet dhe të lajmërojë urgjentisht organet kompetente.

4.4 **Kjo Deklaratë është e vlefshme pasi subjekti të bëjë heqjen nga Fondi Pyjor, në rast se aktiviteti bie në një të tillë. Të ketë në vëmendje të veçantë referencat kadastrale që preken nga ushtrimi i aktivitetit.**

4.5 Referuar mendimit të AKZM-së të ruhen distancat nga monumenti natyror, "Rrethi i plakës".

4.6 Aktiviteti të kryhet brenda sipërfaqes së zonës, sipas planimetrisë, për të cilën është shprehur Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura.

4.7 Ndalohen rreptësisht punimet në këtë zonë, apo cfarëdo lloj veprimtarie që cënonn statusin e saj.

4.8 Në bazë të Ligjit Nr. 81/2017, "Për Zonat e Mbrojtura", neni 17, nga zbatuesit e projektit të merren masa që mos të dëmtohet zona me status të vecantë, për të cilën zbatohet shkalla e mbrojtjes, e njëjtë me "Rezervën strikte". Zona mbrohet e menaxhohet për ruajtjen e karakteristikave dhe dukurive të veçanta natyrore, kulturore, historike e arkeologjike, për të cilat është shpallur monument.

4.9 I sugjerohet institucionit përgjegjës për lëshimin e Lejes së Shfrytëzimit, që për përcaktimin e sipërfaqes së shfrytëzimit, të merret parasysh statusi i zonës, (referencë harta e AKZM-së, bashkëlidhur në Aneksin II dhe rekomandimet për sipërfaqen).

### **Gjatë fazës së instalimit:**

4.10 Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore.

4.11 Të instalohet sistemi i eliminimit dhe kapjes së pluhurave, nëpërmjet sprucimit me ujë. (Ky sistem, të detajohet qartë me skica, planimetri etj në aplikimin për Leje Mjedisore)

- 4.12 Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikantëve e të hidrokarbureve në mjedis, emetimin e gazeve të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve të subjektit.
- 4.13 Të respektohet distanca nga rruga, gjatë fazës së instalimit dhe kryerjes së punimeve, sipas legjislacionit në fuqi.
- 4.14 Përdorimi i pajisjeve, automjetet, që emetojnë nivele zhurmash brenda normave të lejuara të emetimit 60 – 100 db.
- 4.15 Subjekti të realizojë në mënyrë të menjëhershme çdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negativ në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tij.
- 4.16 Të sistemohen brenda sipërfaqes së shfrytëzimit të gjitha sterilet e gjeneruara nga shfrytëzimi i karrierës.
- 4.17 Në raste aksidentesh ose defektesh teknologjike që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në DRM-në e qarkut përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e popullatës që preket nga ky aksident.
- 4.18 **Subjekti të hartojë dhe zbatojë një plan masash lidhur me masat e parandalimit dhe shuarjen e zjarreve në rast aksidentesh nga plasjet për nxjerrjen e materialit.**
- 4.19 Të mbillen pemë në të gjithë perimetrin e zonës për të minimizuar ndikimet në mjedis dhe përmirësuar pejsazhin.
- 4.20 Subjekti të kujdeset për menaxhimin e mbetjeve të krijuara gjatë fazës së instalimit, sidomos ato të ambalazhimit, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimit e caktura nga njësia vendore. Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.
- 4.21 Përgjatë gjithë rrugës së brendshme të karrierës (përfshi transhetë), të hapet një kanal ujëmbledhës i orientuar drejt një grope dekantimi, për mbledhjen dhe disiplinimin e ujërave gjatë kohës së shfrytëzimit.
- 4.22 Të bëhet pastrimi i mjeteve të punës para daljes nga kantieri i ndërtimit për të mos shkaktuar ndotje në mjedis.
- 4.23 Të merren masa për mbrojtjen e biodiversitetit të zonës.
- 4.24 **Të kihet kujdes treguesit kadastralë të sipërfaqes pyjore/kullosore që do të përdoret për aktivitetin, të jenë vetëm brënda sipërfaqes së miratuar.**
- 4.25 **Personi përgjegjës teknik për zhvillimin e aktivitetit duhet të jetë i informuar për bazën ligjore të pyjeve në fuqi dhe për zbatimin e tyre.**
- 4.26 Subjekti të respektojë kushtet lidhur me mbrojtjen e biodiversitetit, menaxhimin e pyjeve, emetimet në ajër, shkarkimet e ujërave të ndotura, menaxhimin e mbetjeve etj.
- 4.27 Subjekti të respektojë dhe të mbajë parasysh kërkesat dhe kriteret e Ligjit Nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura”.
- 4.28 Kompania duhet të respektojë gjithashtu kushtet e vendosura në raportin e VNM-së të aplikuar si dhe Ligjin Nr. 10 431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.
- 4.29 Në përfundim të punimeve, të rehabilitohet zona e shfrytëzuar.
- 4.30 **Duke qënë se gjatë fazës së funksionimit, ky aktivitet do të ketë efekte në mjedis, në bazë të Ligjit Ligj nr. 52/2020, datë 30.4.2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar.**

## 5. Monitorimi dhe Raportimi

Në bazë të Ligjit Nr. 128/2020 Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, të ndryshuar, Neni 25/1 “Monitorimi dhe vlefshmëria”, zhvilluesi ka detyrimet si më poshtë:

### - Zhurma dhe Vibracionet

- Të zbatohen nivelet kufi të zhurmës, referuar Udhëzimit Nr. 8, date 27.11.2007 “Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara” dhe Ligjit Nr.9774 date 12.07.2007 “Për vleresimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”
- Të merren masa për mbrojtjen e punonjësve nga zhurmat.
- Të merren masat për kufizimin e orareve të punës në kantier.
- Operatori duhet të parandalojë gjenerimin e zhurmës impulsive në zonat e ndjeshme ndaj zhurmës, gjatë operimit të instalimeve.
- Vibrimet në vende të ndjeshme nuk duhet të kalojnë 10 mm/s (PPV) në çdo kohë.
- Të bëhet monitorimi i zhurmave për mjediset: automjete/kamiona në hyrje të kantierit, kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

*Tabela e niveleve kufi:*

Mjedisi	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Ditë	Vlera kufi e zhurmës dB(A) Leq, T Mbrëmje	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Automjete/kamiona ne hyrje te kantierit	55	45	21.07.2023	Çdo 6 muaj
Kantier ndertimi	55	45	21.07.2023	Çdo 6 muaj
Mjedisi urban me i afert me kantierin	55	45	21.07.2023	Çdo 6 muaj

### - Shkarkimet në Ajër

- Të zbatohen nivelet kufi të shkarkimeve në ajër, referuar Ligjit Nr. 162/2014 “Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis” dhe VKM Nr. 248, datë: 24.03.2003 “Për Miratimin e Normave të Përkohshme të Shkarkimeve në Ajër dhe Zbatimin e tyre”.
- Shkarkimet në ajër të jene brenda normave të lejuara, duke marre masa për reduktimin e tyre.
- Kantieri në të cilin emetohen lëndë grimcore në ajër, duhet të pajiset sipas mundësive teknike dhe mbi bazën e natyrës së procesit, me rrjeta uji / sisteme spërkatje / sisteme heqje pluhurash.
- Të bëhet monitorimi i nivelit të pluhurave në ajër, për mjediset: kantier ndërtimi dhe mjedisi urban më i afert me kantierin çdo 6 muaj.

*Tabela e niveleve kufi*

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lënda grimcore (PM <sub>2.5</sub> )	20-25 µg/m <sup>3</sup>	21.07.2023	Çdo 6 muaj
PM <sub>10</sub>	50 µg/m <sup>3</sup> , 40 µg/m <sup>3</sup>	21.07.2023	Çdo 6 muaj

### - Cilësia e ujrave

*Parametrat që duhet të monitorohen*

Ndotësi	Përqëndrimi	Raportimi në AKM	Periodiciteti
Lëndët në pezulli	50 mg/l	21.07.2023	Çdo 6 muaj

### - Subjekti duhet të sjellë pranë AKM-së si më poshtë:

- Informacion në momentin e fillimit të punimeve
- Raportimin periodik për parametrat që do të monitorohen sipas datës së raportimit/



çdo 6 muaj.

- Informacion në përfundim të punimeve, lidhur me punimet rehabilituese të territorit përreth, shoqëruar edhe me foto.
  
- **Afati i Vlefshmërisë**
  - Vendimi për VNM-në paraprake për projektin e propozuar është e vlefshme për aq kohë sa është i vlefshëm edhe dokumenti i miratimit të zhvillimit për projektin.
  - Nëse projekti, që i është nënshtruar procesit të VNM-së, nuk fillon zbatimin në terren brenda 2 vjetëve nga data e miratimit të deklaratës mjedisore apo të vendimit për VNM-në paraprake, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para.

*Në bazë të udhëzimit të MM dhe MF nr. 7938, datë 17.7.2014 “Për përcaktimin e tarifave dhe vlerave përkatëse për shërbimet që kryen Ministria e Mjedisit për procesin e VNM-së”, ky subjekt ka kryer pagesën 50.000 lekë.*

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**ARTA DOLLANI**

**MINISTRI**


**MIRELA KUMBARO FURXHI**

*Konceptoi:*

*Pranoi:*

**Aneksi 1. Harta me Koordinatat** (sipas Njoftimit Fitues)

**Zona Nr...(zona270/5)**





**Aneksi II. Harta me koordinatat** I sugjerohet institucionit përgjegjës për lëshimin e Lejes së Shfrytëzimit, të merret parasysh statusi i zonës, (referencë harta e AKZM-së, bashkëlidhur në Aneksin II dhe rekomandimet për sipërfaqen).

